



Pranuar / Dorezuar Prijeto/Prodato Received/Delivry	18.05.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Pror Br. Pror Pror No	Shkronja Pror y Appenra	Sasia Kolicina Quantity
SKMSH CK	2899/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.351/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.351/2022,të datës 08.04.2022 të parashtruar nga ankuesi nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.05.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.351/2022 e datës 08.04.2022,e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Akt emërimi Nr. 01-112-697 i datës 23.003.2022 i lëshuar nga Kryetari i Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 08.04.2022 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokollit: 1974/2022, me pretendimet ankimore, lidhur me nxjerr e Akt emërimit Nr. 01-112-697, të datës 23.03.2022 nga Kryetari i Komunës së Prishtinës, me qëllimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit dhe urdhrin për përmbarimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Prishtinës. Ndërsa Këshilli me datë 28.04.2022, ka pranua nga Komuna e Prishtinës përgjigjen në kërkesë me numër protokoli:1840/2022, së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.351/2022 e datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesi me numër protokoli:1974/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 23.03.2022, me numër Nr. 01-112-697; Urdhri për përmbarim CP. Nr. 108/18, i datës 25.02.2022; Urdhri për përmbarim CP. Nr. 108/18, i datës 03.02.2020; Aktvendimi c. P Nr. 108/18, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Vendimi i datës 24.11.2017,A.Nr. 02/677/2017, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 04.08.2017,A.Nr. 02/324/2017, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi 01.nr. 112-697, i datës 01.02.2017; Akt emërimi 01.nr. 112-697, i datës 11.03.2013; Kontrata e punës e datës 01.03.2006; Përgjigjen në ankesës e datës 28.04.2022 me numër protokoli 2487/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *pabazuar*, sepse:

Fillimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon së Kryetari i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së Aktit të emërimit me numër: Nr. 01-112-697 të datës 23.03.2022 me të cilin ankuesin e ka emëruar në pozitën "Zyrtar për Hipoteka" me qëllim të zbatimit të Vendimit A. Nr. 02/677/2017, të datës 24.11.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Urdhrit për përmbarim Cp.nr. 108/18, i datës 25.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me obligimet ligjore ndërsa me plotësimin e ankesës sipas shkresës së datës 28.04.2022 ankuesi pretendon se Kryetari i Komunës së Prishtinës e ka degraduar në pozitë dhe se i njëjti është dashur të caktohet në pozitën "Zyrtar i Lartë për kadastër dhe Gjeodezi".

Kolegji ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendim A.Nr.02/677/2017 të datës 24.11.2017 ankuesit i ka aprovuar ankesën, me të cilin vendim ka obliguar Kryetarin e Komunës së Prishtinas, që të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit dhe në arsyetimin e vendimit të Këshillit, është konstatuar së baza juridike në rastin e nxjerrjes së akt emërimit me numër 01 nr. 112-697, të datës 01.02.2017 në pjesën hyrëse të Akt Emërimit është përcaktuar se, citoj: "*themelimin e marrëdhënies së punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit*", ndërsa në rastin konkret nuk ka pasur zhvillim të procedurave të rekrutimit por ka pasur riorganizim të institucionit punëdhënës dhe si bazë për nxjerrjen respektivisht për ndryshimin dhe plotësimin e akt të emërimit ka qenë neni 11 i Rregullores 07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil, prandaj Kolegji konstaton se me rastin e nxjerrjes së Akt emërimit Nr. 01-112-697 të datës 23.03.2022 , me të cilin ankuesin e ka emëruar në pozitën "Zyrtar për Hipoteka", Kryetari i Komunës së Prishtinës ka vepruar duke u bazuar në dispozita ligjore në fuqi.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka gjetur se Kryetari i Komunës së Prishtinës, në rastin e nxjerrjes së Akt emërimit të datës 23.03.2022 Nr. 01-112-697 me të cilin ankuesin e ka emëruar në pozitën "Zyrtar për Hipoteka" me qëllim të zbatimit të Vendimit A.nr.02/677/2017 të datës 24.11.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka vepruar në pajtim me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: "1. *Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës*" dhe mbi bazën e kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Prishtinës, në rastin e nxjerrjes së Akt emërimit për ankuesin me qëllim të zbatimit të Vendimit A. Nr. 02/677/2017, të datës 24.11.2017, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Urdhrit për përmbarim Cp.nr. 108/18 i datës 25.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, këtë veprimin juridikë e ka bërë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi pasi që sipas katalogut të titujve dhe vendeve të punës në Shërbimin Civil të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar nga Ministri i Ministrisë së Administratës Publike me datë 21.02.2018 përmes vendimit me numër:9, pozita "Zyrtar për Hipoteka" me numër të kodit të vendit të punës KG/050 dhe gradë dhjetë (10) është ekuivalente për nga kategoria funksionale me pozitën të cilën e ka mbajtur ankuesi sipas aktit të emërimit të datës 11.03.2013 me numër:01-112-697 pasi që edhe koeficienti i pagesës ka qenë gjashtë (6).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Kryetari Komunës së Prishtinës të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e akt emërimit në bazë të kualifikimit të përvojës së punës përshkrimin e detyrave të punës duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/114 për Zyrtaret Publik në pozitën "Zyrtar i Lartë për kadastër dhe Gjeodezi", ndërsa Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, sepse në kohën e nxjerrjes së vendimit A.Nr. 02/677/2017 të datës 24.11.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka qenë në fuqi Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe po ashtu akti i emërimit të ankuesit i datës 11.03.2013 me numër:01-112-697 koeficienti ka qenë gjashtë (6) respektivisht grada (10), sikurse edhe në aktin e emërimit të datës 01.02.2017 grada është përcaktuar dhjetë (10) që është i përputhet koeficientit për pagë gjashtë (6), ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit që Komuna e Prishtinës të obligohet që aktin e emërimit apo ankuesin ta caktojë në pozitën "Zyrtar i Lartë për kadastër dhe Gjeodezi" e që sipas katalogut të vendit të punës për këtë pozitë grada është e përcaktuar tetë (8) dhe koeficienti tetë (8), andaj mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar ngase i njëjti po kërkon ngritje të koeficientit dhe apo rritje të gradës, të cilën gradë nuk e ka pasur as sipas aktit të emërimit të datës 11.03.2013.

Kolegjin për shqyrtim dhe vendosjen e ankesave pasi që ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit të gjitha provat dhe faktet relevantë, lidhur me ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshill, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara, ndërsa veprimi juridik i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, sa i përket nxjerrjes së akt emërimit me qëllimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe urdhrit për përmbarimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, është në pajtim me dispozitat ligjore të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e ndryshimit dhe plotësimit të aktit të emërimit.



Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 351 /2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, dhe
- Arkivit të KPMShCK-së